

Nr.12 Tetor 2019

## Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendos për përmbylljen e procedurës së ngritjes në detyrë për 8 prokurorë kandidatë për Prokurorinë e Posaçme

- *Brenda muajit nëntor 2019 KLP do të përfundojë emërimin e 8 kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (KKKO)*

Për emërimin e 15 kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, të renditur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë gjatë muajit [korrik 2019](#), është i detyrueshëm konfirmimi në detyrë i tyre nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit. Megjithatë të dyja institucioneve të rivlerësimit kalimtar i është kërkuar përshpejtimi i procedurave për 15 kandidatët për prokurorë të posaçëm, me qëllim avancimin e procesit të emërimit të tyre në organin e hetimit, vetëm 11 prej tyre i janë nënshtruar këtij procesi dhe 8 prej tyre janë konfirmuar në detyrë në të dyja shkallët.

Ligji parashikon përbërjen e Prokurorisë së Posaçme me të paktën 10 prokurorë dhe respektimi i këtij numri ka qenë në mënyrë të vazhdueshme një [çështje për diskutim](#) edhe brenda vetë KLP-së. Megjithatë, në [seancën e fundit plenare](#) të zhvilluar në datën 25 tetor 2019, Këshilli ka vendosur të fillojë procedurat e emërimit të 8 prokurorëve të posaçëm (të konfirmuar në të dyja shkallët), duke [theksuar](#) se emërimi i më pak se 10 prokurorëve të posaçëm nuk do të sjellë fillimin e funksionimit të SPAK. Organigrama dhe numri i prokurorëve të posaçëm për fillimin e punës së institucionit do të përcaktohen vetëm nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i cili do të zgjidhet nga rradhët e prokurorëve të posaçëm, menjëherë pas emërimit të tyre.

Për këtë qëllim, Komisioni i Posaçëm për ngritjen e SPAK pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë [ka propozuar](#) disa hapa në funksion të konstituimit të Prokurorisë së Posaçme (SPAK), të cilat janë miratuar unanimisht nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e fundit.

Propozimet e Komisionit të Posaçëm përfshijnë:

SPAK Info Nr. 12, informon mbi zbatimin e hapave nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për emërimin e 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme brenda muajit nëntor 2019.

Gjithashtu ky numër përshkruan ritmet e vetting-ut për kandidatët gjyqtarë në Gjykatat e Posaçme si edhe thekson koordinimin e hapave për ngritjen e njëkohshme të institucioneve të reja kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Për shumë informacion mbi zbatimin e hapave ligjorë në drejtim të ngritjes së Gjykatave të Posaçme dhe SPAK mund të lexoni Buletinet 3-mujore SPAK Monitor të publikuara në faqen e CSDG: [www.csdgalbania.org](http://www.csdgalbania.org)

Publikimet realizohen në kuadër të projektit “Monitorimi dhe vlerësimi i procesit të ngritjes dhe funksionimit të Gykatave të Posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe Strukturës së Posaçme SPAK, nëpërmjet hulumtimit, informimit, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes në ngritjen e kapaciteteve administrative”, i mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.

1. Përmbylljen brenda 30 ditëve (brenda muajit nëntor 2019) të procedurës për ngritjen në detyrë për 8 prokurorët kandidatë për Prokurorinë e Posaçme dhe emërimin e tyre;

2. Përgatitjen e akteve të nevojshme për miratim, të cilat përfshijnë:

- Vendimet për emërimin e 8 prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme;
- Vendimin për caktimin e përhershëm të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme me mandat 3 vjeçar nga 8 prokurorë të emëruar në Prokurorinë e Posaçme;
- Ndërprerjet e caktimeve të përkohshme për prokurorë që janë të emëruar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe ushtrojnë detyrën pranë një prokurorie tjetër;
- Ndërprerjet e caktimeve të përkohshme për prokurorë që janë të caktuar në Prokurorinë e Krimeve të Rënda por janë emëruar pranë një prokurorie tjetër.

3. Autorizimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për koordinimin e punës me Këshillin e Lartë Gjyqësor për të marrë në mënyrë të njëkohshme vendimet përkatëse për Gjykatën e Posaçme dhe Prokurorinë e Posaçme.

4. Hapjen e menjëhershme të garës nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për shprehjen e interesin nga ana e 8 prokurorëve tashmë të emëruar për pozicionin e drejtuesit për një mandate 3-vjeçar (fazë e cila është parashikuar të zgjasë 5 ditë).

I gjithë procesi dhe hapat e parashikuar më lart do të realizohen brenda një periudhe kohore 30 ditore, brenda muajit nëntor 2019. Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të përmbyllë në këtë mënyrë, një nga fazat më të rëndësishme në drejtim të ngritjes së Prokurorisë së Posaçme, e cila do të vijojë me përbushjen e hapave të tjerë ligjorë me qëllim fillimin sa më të shpejtë të veprimtarisë dhe funksionimit të institucionit kryesor të hetimit në vend.

	Kandidatët e renditur për ngritje në detyrë në Prokurorinë e Posaçme (korrik 2019)	Statusi i vetting-ut	Kandidatët, të cilët do të emërohen në Prokurorinë e Posaçme (nëntor 2019)
1.	Altin Dumani	Konfirmuar në detyrë	1. Altin Dumani 2. Arben Kraja 3. Klodian Braho 4. Enkeleda Millonai 5. Edvin Kondili 6. Ened Nakuçi 7. Elida Kaçkini 8. Behar Dibra
2.	Anton Martini	Në proces rivlerësimi	
3.	Elizabeta Imeraj	Në proces rivlerësimi	
4.	Arben Kraja	Konfirmuar në detyrë	
5.	Doloreza Musabelliu	Në proces rivlerësimi	
6.	Klodian Braho	Konfirmuar në detyrë	
7.	Enkeleda Millonai	Konfirmuar në detyrë	
8.	Manjola Kajana	Konfirmuar nga KPK/Ankimuar	
9.	Edvin Kondili	Konfirmuar në detyrë	
10.	Ened Nakuçi	Konfirmuar në detyrë	
11.	Elida Kaçkini	Konfirmuar në detyrë	
12.	Ndini Tavani	Shkarkuar nga detyra	
13.	Behar Dibra	Konfirmuar nga KPK	
14.	Anita Jella	Në proces rivlerësimi	
15.	Besnik Muçi <sup>1</sup>	Konfirmuar nga KPK/Ankimuar	

\* Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ([www.kpk.al](http://www.kpk.al)), Institucioni i Komisionerëve Publikë ([www.ikp.al](http://www.ikp.al)) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit ([www.kpa.al](http://www.kpa.al))

<sup>1</sup> Kandidati Besnik Muçi u emërua nga Presidenti i Republikës në 15 tetor 2019 gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, duke u përjashtuar nga gara për prokuror në Prokurorinë e Posaçme KKKO.

## **Gjykatat dhe Prokuroritë e Krimeve të Rënda përgatisin dosjet në kompetencë të Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme**

Në vijim të hapave të ndërmarrë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për emërimin e prokurorëve të posaçëm si edhe koordinimeve të mëtejshme me Këshillin e Lartë Gjyqësor, me ngritjen e organeve të reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do të pushojnë së funksionuari Gjykatat e Krimeve të Rënda dhe Prokuroritë e Krimeve të Rënda. Për këtë arsye drejtuesit e këtyre institucioneve në bashkëpunimin me stafet respektive kanë filluar [inventarizimin](#) e dosjeve për korrupsionin dhe krimin e organizuar, të cilat pritet ti kalojnë për shqyrtim së shpejti Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme KKKO.

Aktualisht në Prokurorinë e Krimeve të Rënda po hetohen [570 dosje, nga të cilat 170](#) do ti kalojnë për kompetencë Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjithashtu këtij organi do ti kalojnë për kompetencë edhe dosje të Prokurorive të Rretheve, të cilat lidhen me veprat e hetimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar për të [zgjedhurit vendorë apo zyrtarë të tjerë të lartë](#). Ndërkohë problematike konsiderohet [lëvizja e rreth 12 prokurorëve aktualë të krimeve të rënda](#), të cilët nuk do të jenë pjesë e SPAK dhe të cilët do të emërohen në vendet vakante të Prokurorive të Rretheve të krijuara nga procesi i vetting-ut.

Edhe Gjykatat e Krimeve të Rënda kanë marrë masat në drejtim të kalimit të çështjeve mbi veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat do të gjykohen nga Gjykatat e Posaçme KKKO. Vetëm pak kohë më parë, vetë [Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda](#), ka deklaruar se aktualisht mbi 30 dosja me 200 të paraburgosur (të pandehur), për çështje të korrupsionit dhe krimit të organizuar në Gjykatën e Krimeve të Rënda pritet ti kalojnë për shqyrtim Gjykatës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjithashtu janë përmendur edhe [hapa të tjerë të rëndësishëm](#), të tilla si marrja e masave organizative, hartimi i Strategjisë për Buxhetin, ridimensionimi i sistemit të sigurisë dhe aftësimi i teknologjisë për serverat, rregjistrat si dhe emërtesat dhe togat e reja.


Përveç koordinimit të veprimtarive të dy Këshillave, edhe harmonizimi i hapave dhe marrja e masave nga institucionet kryesore aktuale siç janë Gjykatat dhe Prokuroritë e Krimeve të Rënda është i rëndësishëm për konstituimin e njëkohshëm të organeve të reja kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

## **Procesi i rivlerësimit ende i ngadaltë për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda: Më shumë se gjysma e tyre nuk i janë nënshtruar ende vetting-ut**

- *Përsheptimi i zhvillimit të seancave dëgjimore dhe vendimet e institucioneve të rivlerësimit thelbësore për ngritjen e harmonizuar të Gjykatave të Posaçme dhe SPAK*

Për ngritjen e njëkohshme të Gjykatave dhe Prokurorisë së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nevojitet një koordinim edhe në drejtim të ritmeve të seancave dëgjimore për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda, të cilët janë kandidatët kryesore për të kaluar në Gjykatat e Posaçme. Sikurse edhe në rastin e prokurorëve të posaçëm, legjislacioni parashikon një numër të caktuar gjyqtarësh të posaçëm, specifikisht 16 gjyqtarë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë dhe 11 gjyqtarë në Gjykatën e Posaçme të Apelit.

Megjithatë, ritmet e seancave për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda vazhdojnë të jenë të ngadalta, pasi nga 14 gjyqtarë pjesë e kësaj Gjykate vetëm 1 prej tyre i është nënshtruar vetting-ut. Duke ju referuar këtyre ritmeve, përsheptimi i seancave për këto gjyqtarë mbetet një faktor i rëndësishëm me qëllim emërimin e përhershëm të tyre në Gjykatat e Posaçme KKKO. Ndërkohë, nga 11 gjyqtarë të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda 5 prej tyre janë shkarkuar nga KPK, një numër i konsiderueshëm për mosplotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Posaçme të Apelit.



\* Vendimet e dhëna nga KPK për gjyqtarët e Gjykatave të Krimeve të Rënda, Burimi: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ([www.kpk.al](http://www.kpk.al)), Institucioni i Komisionerëve Publikë ([www.ikp.al](http://www.ikp.al)) dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit ([www.kpa.al](http://www.kpa.al))

Mundësia e mosplotësimin të numrit të caktuar të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme është pohuar edhe nga vetë drejtues të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Zv/Kryetari i KLGJ ka [theksuar](#) problematikën e numrit të lartë të shkarkimeve, e cila mund të sjellë mosplotësimin e vendeve vakante në Gjykatat e Posaçme KKKO, veçanërisht atë të apelit, duke rrezikuar si pasojë mos ngritjen e këtyre institucioneve dhe krijimin e vonesave të tjera.

Megjithëse funksionimi i Gjykatave të Posaçme është parashikuar të fillojë edhe me emërimin e përkohshëm të gjyqtarëve aktualë të krimeve të rënda, faktorë të tjerë si numri i lartë i shkarkimeve nga detyra apo vendimeve të ankimuar do ta bënin të pamundur vazhdimin e funksionit të gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme. Për ti paraprirë vonesave të krijuara si rezultat i numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve duhet që KPK dhe KPA të përsheptojnë ritmet e rivlerësimit kalimtar të kandidatëve për emërim në Gjykatat e Posaçme pasi rezultatet e vendimeve të marra për gjyqtarët aktualë do të përcaktojnë numrin e vendeve vakante në këto Gjykata. Kjo do t'i mundësojë KLGJ shpalljen e vendeve vakante për të plotësuar numrin e nevojshëm të gjyqtarëve të parashikuar në ligj për ngritjen e Gjykatave të Posaçme.

## I. Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe apelit për Krime të Rënda

Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda					
		Seanca Dëgjimore	Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Sandër Simoni		Në proces rivlerësimi		
2.	Ardit Mustafaj		Në proces rivlerësimi		
3.	Irena Gjoka		Në proces rivlerësimi		
4.	Daniela Shirka		Në proces rivlerësimi		
5.	Etleva Deda		Në proces rivlerësimi		
6.	Luan Hasneziri	27.05.2019	Shkarkuar nga detyra		
7.	Flora Hajredinaj		Në proces rivlerësimi		
8.	Fran Prendi		Në proces rivlerësimi		
9.	Ilirjana Olldashi		Në proces rivlerësimi		
10.	Liljana Baku		Në proces rivlerësimi		
11.	Marsela Balili		Në proces rivlerësimi		
12.	Bib Ndreca		Në proces rivlerësimi		
13.	Miliana Muça		Në proces rivlerësimi		
14.	Klodian Kurushi		Në proces rivlerësimi		
Statusi i vetting-ut për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Apelit për Krime të Rënda					
1.	Fehmi Petku	02.04.2019	Shkarkuar nga detyra	Vendimi i KPK i pa ankimuar/Ankimuar si subjekt	Në proces
2.	Gjovalin Pernoca	30.07.2019 & 10.09.2019	Shkarkuar nga detyra		
3.	Nertina Kosova	17.07.2018	Konfirmuar në detyrë	Vendimi i KPK ankimuar në KPA	Konfirmuar nga KPA
4.	Dhurata Haveri	25.09.2019	Shkarkuar nga detyra		
5.	Nure Dreni		Në proces rivlerësimi		
6.	Saida Dollani	20.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
7.	Dhimitër Lara	27.05.2019	Konfirmuar në detyrë		
8.	Sokol Binaj	17.05.2019	Konfirmuar në detyrë		
9.	Gurali Brahimllari	18.06.2019	Shkarkuar nga detyra		
10.	Idriz Mulkurti	12.06.2019	Shkarkuar nga detyra	Vendimi i KPK i pa ankimuar/Ankimuar si subjekt	Në proces
11.	Albana Boksi	04.04.2019	Konfirmuar në detyrë		

\* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 26 tetor 2019

## II. Statusi i vetting-ut për 14 kandidatët të renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Statusi i vetting-ut për 15 kandidatët e renditur për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar					
		Seanca Dëgjimore	Vendimi i KPK	Vendimi i IKP	Vendimi i KPA
1.	Altin Dumani	30.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
2.	Anton Martini		Në proces rivlerësimi		
3.	Elizabeta Imeraj		Në proces rivlerësimi		
4.	Arben Kraja	13.12.2018	Konfirmuar në detyrë		
5.	Doloreza Musabelliu		Në proces rivlerësimi		
6.	Klodjan Braho	25.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
7.	Enkeleda Millonai	13.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
8.	Manjola Kajana	18.06.2019	Konfirmuar në detyrë	Vendimi i KPK <b>ankimuar në KPA</b>	Në proces
9.	Edvin Kondili	06.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
10.	Ened Nakuçi	06.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
11.	Elida Kaçkini	16.07.2019	Konfirmuar në detyrë		
12.	Ndini Tavani	07.10.2019	<b>Shkarkuar nga KPK</b>		
13.	Behar Dibra	20.06.2019	Konfirmuar në detyrë		
14.	Anita Jella	04.10.2019	Në proces rivlerësimi		

\* Statusi i rivlerësimit është përditësuar për herë të fundit në datën 26 tetor 2019